

VENDIM
Nr. 515, datë 1.7.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PORTIT TURISTIK DHE TË SHËRBIMEVE “MARINA LIMION”, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË “KASTRATI GROUP” SHA DHE “EDIL-AL-IT” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kastrati Group” sh.a. dhe “Edil-Al-It” sh.p.k.
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama